

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gucati: Kurti ta përjashtojë nga Qeveria Gërvallën, ka dorëzuar dokumente në Hagë
ADRESA	https://www.koha.net/arberi/gucati-kurti-ta-perjashtoje-nga-qeveria-gervallen-ka-dorezuar-dokumente-ne-hage
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 02:46:29 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 10:46:15 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	aa3e4eb41b7cfa4f6fe6f2adb99635bd15a1fdeae0f92e5a5d55e8cf7c5699b6
TEKSTI	e24146fa7321eaa0737f21ff7c3af070e29856cd6c48480570a0762b9a7520ae
PAMJA	3cc1518bd78663c7a061a09ada426ad3a3f73fe6a79ffb515b44223cd9d4d1ff

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	13eda263f9c4feefc3df776c879ed7dc64cdfca6f67643afe44db133c42be5d8
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	d168eddf93fa1caf9b52e38b024f9c0c6b0c560715a6b0a77bc6eba75d9be5be
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/13eda263f9c4feefc3df776c879ed7dc64cdfca6f67643afe44db133c42be5d8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

ARBËRI

Gucati: Kurti ta përjashtojë nga Qeveria Gërvallën, ka dorëzuar dokumente në Hagë



Foto: Driton Paçarada

18 shtator 2026 12:46

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanal in tonë zyrtar në Viber

Kryetari i OVL-UÇK-së, Hysni Guçati, i ka drejtuar një kërkesë Gjykatës Speciale e një Qeverisë në Kosovë.

Ai ka kërkuar nga gjykata që vendimin dënues ndaj ish-krerëve të UÇK-së ta shfuqizojë, e i ka kërkuar kryeministrit Albin Kurti që ta shkarkojë ministrën e Drejtësisë, Donika Gërvalla.

“Ne sot na befason që ende institucionet nuk e kanë thënë asnjë fjalë. Në vend që Donika Gërvalla të japë një deklaratë për një padrejtësi që është bërë për çlirimtarët, ajo sot hesht. Ne e dimë që Donika Gërvalla ka dorëzuar dokumente në Hagë, ne e dimë që Liburn Aliu ka folur në parlament, i themi Albin Kurtit që këta njerëz t'i përjashtojë nga Qeveria. Njerëz që bashkëpunojnë me armikun, janë armiq të vendit dhe kombit dhe ne nuk i duam në mesin tonë”, ka thënë ai para protestuesve.

Gucati i ka kërkuar edhe Gërvallës kërkimfalje e sqarim Liburn Aliut. Aliu ishte ministër i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturs, deri në gusht të vitit 2025, kur dha dorëheqje. Aktualisht, ai ushtron pozitën e drejtorit të portit të Durrësit në Shqipëri.

“Më befason Kurti si e mban ende në zyre një njeri që nuk e thotë asnjë fjalë. Gërvalla le të kërkojë falje, kërkojmë sqarim nga Gërvalla dhe Aliu të deklarojnë ku i morën ato informata, kush janë ata që i kanë vrarë ata njerëz. Jo të drejtohet gishti nga pjesëtarët e UÇK-së”.

LEXO PËRDITËSIMET TJERA



Mijëra qytetarë protestojnë kundër vendimit të Speciales ndaj ish-krerëve të UÇK-së

Mijëra qytetarë kanë protestuar në sheshin “Skënderbeu” në Prishtinë, në protestën e thirrur nga Organizata e...

Kulturë.

“A Chip Odyssey” dekodon frymën e zhvillimit të Tajvanit

Arbëri.

Jashari: Kosova duhet të sillet si e rritur karshi Evropës dhe Amerikës

Arbëri.

Jashari: PDK-ja duhet ta ketë Ministrinë e Drejtësisë

Futboll.

Brentfordi turpëron Chelsea

LAJMET E MBRËMJES.

Bashkëpunëtorë dhe bashkëveprimtarë e kujtojnë kontributin e Flora Brovinës

Futboll.

Bayerni me fitore 7:0, Kane vendos rekord

Artikuj të ngjashëm

- 

LAJMET E MBRËMJES • 5 o. më parë
Për të tretën ditë rresht, mijëra qytetarë protestojnë në Prishtinë kundër vendimit të Speciales
- 

Arbëri • 9 o. më parë
Peci: Stop sulmeve ndaj Donika Gërvallës
- 

Arbëri • 17 sht 2026
Deliu-Gërvallës: Ke pasur gjithmonë akuza për UÇK-në, tash nuk e paske asnjë fjalë
- 

LAJMET E MBRËMJES • 25 gus 2026
Gucati: E mbështesim marshin e 12 shtatorit, por s'mund të jemi aty ku ftohet VV-ja
- 

Arbëri • 25 gus 2026
Gucati: E mbështesim "Marshin për liri", por nuk mund të jemi aty ku ftohet Vetëvendosje

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografite, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësisë që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

- Marketing
- Politika e privatësisë
- Kushtet e përdorimit
- Udhëzim për përdorimin e IA-së
- Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 /

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

Aneksi i Ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS

